



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government**

*Ministria e Punëve te Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*



Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike / Odbor Kosovske Akademije za Javnu Bezbednost / Board of Kosovo Academy for Public Safety

---

**PLANI VJETOR I PUNËS**

**SË BORDIT TË AKADEMISË SË KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE**

**PËR VITIN 2018**

**15 Mars 2018**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**



*Ministria e Punëve te Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike / Odbor Kosovske Akademije za Javnu Bezbednost / Board of Kosovo Academy for Public Safety

Nr. 4/22  
Datë: 15.03.2018

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike si dhe në bazë të nenit 4 dhe nenit 11 të Rregullores Nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në mbledhjën e mbajtur më 15 mars 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Plani vjetor i punës së Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për vitin 2018.
  
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Bajram Bujupi

Kryesues i Bordit

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Bordit, dhe
- Arkivit të AKSP-së

## **Hyrje**

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Akademia ofron shërbimet e trajnimit për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në:

- Policinë e Kosovës;
- Shërbimin Korrektues;
- Shërbimin Sprovues;
- Doganën e Kosovës;
- Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;
- Inspektoratin Policor të Kosovës.

Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (më tutje i referuar si Bordi i AKSP-së) është autoritet i themeluar në përputhje me nenin 17 të Ligjit nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike si dhe i organizuar në bazë të Rregullores nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

Duke pasur një mision të qartë, Bordi i AKSP-së vendos minimumin bazë të standardeve profesionale, politikave që kanë të bëjnë me trajnimet në fushën e sigurisë publike, edukimin e specializuar dhe të avancuar të Institucioneve për siguri publike në Akademi në mënyrë që të pajisë dhe avancojë njojuritë dhe shkathtësitë e duhura për të gjithë pjesëtarët e Institucioneve të sigurisë publike që u shërbejnë qytetarëve të Republikës së Kosovës për të qenë të sigurt në ambientet ku jetojnë dhe veprojnë.

Sfidat përballuese me dukuritë negative kërkojnë që të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit të jenë fleksibile dhe në hap me kohën, andaj Bordi i AKSP-së me qëllim të vendosjes së

standardeve ka përgatitur këtë plan vjetor në përputhje me kompetencat e Bordit të AKSP-së dhe është i ndarë në fushat kyçë të përgjegjësisë siç janë:

- Standardet minimale profesionale
- Politikat për trajnimin në fushën e sigurisë publike
- Politikat për edukimin e specializuar dhe të avancuar
- Shqyrtimi i raporteve periodike dhe vjetore të punës së Akademisë

## **Qëllimi**

Qëllimi i këtij plani vjetor është përcaktimi i hapave kryesore të cilët i ndërmerr Bordi gjatë vitit 2018 me qëllim të kryerjes së përgjegjësive të veta në mënyrë që nëpërmes vendosjes së standardeve dhe politikave të trajnimit dhe edukimit, pjesëtarët e institucioneve të sigurisë publike të jenë sa më të përgatitura në mënyrë profesionale dhe sipas standardeve ndërkombëtare të pranuara, që t'u bëjnë ballë të gjitha sfidave në fushën e sigurisë publike.

Ky plan i punës paraqet prioritetet e Bordit të AKSP-së dhe jep përbledhje të aktiviteteve të planikuara për realizimin e synimeve.

Duke qenë të vetëdijshëm se mund të ketë edhe zhvillime të reja, plani i punës është dokument që do të rishikohet dhe evoluojë vazhdimesht.

### **1. Standardet Minimale Profesionale**

Standardet minimale profesionale janë një sërë kriteresh të dizajnuara për të ndihmuar në matjen e përshtatshmërisë së personit për t'i shërbyer popullit të Kosovës në cilësi të Sigurisë Publike. Ajo duhet të përfshijë standardet minimale të punësimit përkitazi me etikën personale, karakterin, trajnimin dhe kompetencën e personelit të sigurisë publike dhe Akademisë.

Bordi i AKSP-së do të vendos standardet minimale profesionale në përputhje me të gjitha udhëzimet e zbatueshme të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me aftësitë dhe atributet e nevojshme për të kryer funksionet esenciale të pjesëtarit të sigurisë publike e që duhet të respektohen nga Institucionet e Sigurisë Publike.

## **2. Politikat për trajnimin në fushën e sigurisë publike**

Bordi i AKSP-së do të vendos politikat për trajnimin në fushën e sigurisë publike me qëllim të përcaktimit të programeve të trajnimeve duke identifikuar kompetencat thelbësore të nevojshme për kryerjen e kënaqshme të detyrave të pjesëtarit të sigurisë publike. Këto kompetenca duhet të përfshijnë njohuritë dhe aftësitë e identikuara nëpërmjet analizës së detyrave të vendit të punës dhe aftësi tjera që konsistojnë në përputhje me rolin e pjesëtarit të sigurisë publike.

## **3. Politikat për edukimin e specializuar dhe të avancuar**

Bordi i AKSP-së do të vendos politikat për edukimin e specializuar dhe të avancuar duke i identifikuar fushat në të cilat edukimi i tillë është i nevojshëm. Nevojat për edukim të specializuar dhe të avancuar duhet t'i paraqesin Institucionet e sigurisë publike me qëllim të ngritjes së kapaciteteve, koordinimit dhe bashkëpunimit me institucionet relevante.

## **4. Shqyrtimi i raporteve periodike dhe vjetore të punës së Akademisë**

Akademia harton raporte periodike dhe vjetore të punës. Bordi do të shqyrtojë reportin gjashtëmujor të punës së Akademisë dhe reportin vjetor të punës.

Detyrat e Bordit		Aktivitetet		Afati kohor - TM <sup>1</sup>	Njësitë përgjegjëse	Veprimi
1.	<b>Standardet minimale profesionale</b>	1.1	Mbështetja e Bordit të AKSP-së në implementimin e rekomandimeve të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve dhe IADSLES-it	TM1 – TM4	Bordi	Rekomandimet e implementuara
2.	<b>Politikat për trajnime në fushën e sigurisë publike</b>	2.1	Implementimi i aktivitetit 1.1 “ <i>Mbështetja e mëtejme e Bordit të AKSP-së si mekanizëm koordinues për implementimin e trajnimeve profesionale për të gjitha Agjencionet e Sigurisë Publike</i> ” të Komponentët I të projektit të binjakëzimit „Forcimi i mëtejme i edukimit në sigurinë publike“ me fokus te veçantë në strategjinë e re zhvillimore të AKSP-së.	TM1 – TM4	AKSP, PK, DK, AME, IPK, SHKK, SHSK	Aktiviteti i implementuar
		2.2	Hartimi i politikave të përbashkëta për realizimin e fushëveprimit të ligjit të AKSP-së për përbashkëtësimin e standardeve të akreditimit	TM1 – TM4	AKSP, PK, DK, AME, IPK, SHKK, SHSK	Politikat e hartuara
		2.3	Shqyrtimi i planit të trajnimeve të Akademisë	TM4	AKSP, PK, DK, AME, IPK, SHKK, SHSK	Hartimi i planit të trajnimeve
3.	<b>Shqyrtimi i raporteve periodike dhe vjetore të punës së Akademisë</b>	3.1	Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor dhe vjetor i Akademisë	TM1 – TM4	AKSP	Hartimi i raportit gjashtëmujor dhe vjetor

<sup>1</sup> TM – nënkupton afatet kohore të ndara në periudha tre mujore.